



Titulli i projektit

Mbështetja e ZF Shijak për krijim e një Sporteli me Një Ndalesë

Tipi i projektit

Shërbime Publike

Vendndodhja e projektit

Bashkia Shijak

Buxheti i paravlerësuar

100,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Siç theksohet qartë edhe në analizën e NJQV dhe Zonës Funksionale Shijak, cilësia e shërbimeve publike është shumë e ulët dhe në disa raste mungon fare. Një pjesë e mirë e shërbimeve nuk janë të dixhitalizuara dhe komuniteti nuk e di se ku duhet të adresohet për të marrë një shërbim të caktuar. Duke konsideruar edhe bashkimin e 4 NJQV në muajt në vijim, ofrimi i shërbimeve bëhet edhe më i vështirë. Duke ndërtuar një Sportel me Një Ndalesë, pushteti vendor përmirëson ndjeshëm cilësinë e informacionit të dhënë dhe komunikimin me qytetarët, duke rritur transparencën dhe efencën e shërbimit, ndërsa qytetarët mund të marrin disa shërbime njëkohësisht, në kohë më të shkurtër dhe në të njëjtin vend.


Qëllimi/et specifik të projektit

Objektivat e këtij projekti janë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike në komunitet, nëpërmjet ofrimit të shërbimit të dixhitalizuar, në kohë të shkurtër dhe në një vend të caktuar. Gjithashtu, nëpërmjet këtij projekti do të arrihet të lehtësohen procedurat e qytetarëve për të marrë shërbimet e kërkuara, do të shkurtrohet afati i marrjes së shërbimit dhe do të përmirësohet bashkëpunimi qytetar – qeveri vendore.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Të gjitha NJQV e Zonës Funksionale Shijak do të përfitojnë nga ky projekt, bashkë me të gjithë banorët e tyre (27851 persona). Do të përmirësohet ndjeshëm cilësia e dhënies së shërbimeve, informacioneve dhe komunikimi qytetar – nëpunës. Nga ana tjetër, qytetarët do të marrin shërbimet në një kohë më të shkurtër, duke kontaktuar direkt me nëpunësin dhe do të kenë mundësi të informohen e të përfshihen më shumë në proceset vendimmarrëse të qeverisjes vendore.

PROJEKTI 7



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Ky projekt, me kohëzgjatje 16-mujore, përfshin këto aktivitete, si më poshtë vijon:

- Rehabilitimin e ambjenteve ku do të ofrohen shërbimet në Sportelin me Një Ndalesë;
- Pajisjen e ambjenteve me mjetet e duhura;
- Ndërtimi i kapaciteteve;
- Identifikimi dhe vendimmarrja mbi shërbimet që do të ofrohen
- Web i shërbimeve
- Promovimi

Maturimi i projektit

Ka vetëm një koncept të qartë për nevojën dhe mundësitë që do të ofronte zbatimi i këtij projekti. Për zbatimin e këtij projekti, hapi i parë që duhet të ndërmerret është marrëveshja me pushtetin vendor.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Duke marrë në konsideratë pamundësitë financiare të pushtetit vendor për financimin e projekteve të kësaj natyre, do të ishte e përshtatshme që të kërkohej financim nga donatorët e huaj dhe fondet e zhvillimit të rajoneve të Qeverisë Shqiptare.

Vetë pushteti vendor do të ishte aktori më i përshtatshëm për zbatimin e këtij projekti, duke marrë në konsideratë edhe përvojën e grumbulluar ndër vite dhe rolin e tij të natyrshëm në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Kostot e projektit

Duke u bazuar në aktivitetet e përmendura më lart, kostot e përafërta do të ishin si më poshtë:

Rehabilitimi i ambjenteve ku do të ofrohen shërbimet e Sportelit me Një Ndalesë	30,000
Pajisja e ambjenteve me mjetet e duhura	20,000
Ndërtimi i kapaciteteve	3,000
Identifikimi dhe vendimmarrja mbi shërbimet që do të ofrohen	
Web i shërbimeve	3,000
Promovimi	3,000